

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5502
E enjte, 14 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Klinika e Kardiokirurgjisë bëhet edhe me sallën e dytë për operime

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**MAQEDONIA,
EMRI I RI:
NOCIONI
GJEOGRAFIK,
MË I MIRË SE
HISTORIK** F. 11



Lisen BASHKURTI

**TË PREMTEN DITA E PARË E
FITËR BAJRAMIT** F. 5



EKONOMI

**VETËVENDOSJA: VENDIMI PËR
RRITJE TË PAGAVE ËSHTË
KUNDËRKUSHTETUES** F. 9

**KOSOVA PËRFITON NGA
GJERMANIA TETË MILIONË
EURO GRANT** F. 8

SPORT

**VAZHDOJNË NDERIMET PËR
FADIL VOKRRIN** F. 19

**BOTA PREJ SOT KTHEN SYTË
KAH RUSIA, KAH BOTËRORI** F. 19

FLET PËR "EPOKËN E RE", MYFTIU NAIM TËRNAVA F. 4-5

Statusi juridik i bashkësive fetare po zvarritet pa arsye

**- Me rastin e festës së Fitër Bajramit
besimtarëve u dëshiroj mbarësi, paqe,
harmoni, dashuri dhe solidaritet**

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë, ka bërë thirrje që të zgjidhet statusi juridik i bashkësive fetare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tërnavë ka theksuar se pa arsye është duke u zvarritur statusi juridik i bashkësive fetare. Ai ka thënë se draftligji i cili tanimë është në Kuvend nuk u jep zgjidhje bashkësive fetare, megjithatë ato i vë në kuadër të ligjit. Tërnavë ka pohuar se duhet të gjendet zgjidhje që imamët dhe nëpunësit e BIK-ut të kenë pagë të pranueshme dhe të dinjitetshme. Në këtë intervistë Tërnavë ka folur edhe për sfidat me të cilat përballlet institucioni që drejton. Ai ka theksuar se ndër sfidat e BIK-ut janë edukimi dhe ruajtja e besimtarëve në rrugën e drejtë, luftimi i doktrinave ekstremiste, parandalimi i dukurive negative si vetëvrasjet dhe përdorimi i narkotikëve. Tërnavë ka bërë me dije se xhamia qendrore në kryeqytet do të ndërtohet këtë vit

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS, KADRI VESELI, ËSHTË PRITUR NË TAKIM NGA RAPORTUESJA PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN, TANJA FAJON

Fajoni: Kosova ka përmbushur kriteret, liberalizimi gjatë këtij viti

Kosova tashmë ka përmbushur të gjitha kriteret dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë gjatë këtij viti. Kështu ka deklaruar të mërkurën raportuesja për liberalizimin

e vizave për Kosovën, Tanja Fajon, gjatë takimit me kryeparlamentarin Kadri Veseli. Ky i fundit ka theksuar se tanimë Kosova në këtë proces ka nevojë vetëm për vendimmarrje politike F. 7



Haradinaj shpreh gatishmërinë e Qeverisë për të qenë afër komunave

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ivanovi kundërshton marrëveshjen me Greqinë për emrin

Në një paraqitje televizive, presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, tha se marrëveshja e arritur në mes të kryeministrit Zoran Zaev dhe Alexis Tsipras, në të cilën parashihet emri "Maqedonia e Veriut", është antikushtetuese, e dëmshme për interesat shtetërore dhe kombëtare maqedonase



SHKUP, 13 QERSHOR - Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov, ka bërë me dije se nuk do ta dekretojë marrëveshjen për çështjen e emrit mes Qeverisë së Maqedonisë dhe të Greqisë. Në një paraqitje televizive, Ivanov tha se marrëveshja e arritur në mes të kryeministrit Zoran Zaev dhe Alexis Tsipras, në të cilën parashihet emri "Maqedonia e Veriut", është antikushtetuese, e dëmshme për interesat shtetërore dhe kombëtare maqedonase. "Me këtë marrëveshje shkelet mbi premtimin e paraardhësve tanë, të atyre që me zemër të pastër realizuan ëndrrën tonë për një Maqedoni të vetme. Me këtë marrëveshje zhduket historia për Maqedoni të pavarur. Atyre që lindin u mohohet e drejta të quhen maqedonas. Me këtë marrëveshje rrënohet

karakteri unitar i shtetit, ndryshohet Kushtetuta, preambula e saj dhe gjithçka që ka të bëjë me termin maqedonas", tha presidenti Ivanov duke prezantuar qëndrimin e tij se nuk do ta legalizojë marrëveshjen të cilët e quajti "ndërtim pa leje". Kreu i shtetit tha se kjo marrëveshje rrënon edhe raportet në shoqëri, ndërsa akuzoi edhe për mungesë të transparencës, e cila, sipas tij, ka pamundësuar arritjen e konsensusit nacional. Ivanovi tha se në 73 vjetët e fundit Maqedonia nuk ka pasur marrëveshje më të keqe se kjo, ndërsa theksoi se integrimi euroatlantik nuk duhet të shërbejë si alibi për marrëveshje të "dëmshme" që rrënojnë themelet e shtetit. "BE-ja dhe NATO-ja nuk duhet të jetë alibi për marrëveshje të

keqe. Një marrëveshje e tillë polarizon në vend se ta bashkojë shoqërinë, prandaj nuk do të legalizoj marrëveshje të tilla. Kjo është fjala ime e fundit", tha Ivanov. Deklarata e Ivanovit pasoi një takim të tij me kryeministrin Zoran Zaev, nga i cili kishte marrë marrëveshjen e arritur të martën. Takimi, sipas komunikatës së Presidencës, ka zgjatur vetëm dy minuta ndërsa, sipas Qeverisë, takimi është braktisur nga Ivanov duke i pamundësuar kryeministrit dhe shefit të diplomacisë të sqarojnë, siç thuhet, "përfitimet e shtetit nga marrëveshja e arritur".

"Kryeministri Zaev dhe ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, kishin një përpjekje konstruktive për prezantimin dhe shqyrtimin e përmbajtjes së marrëveshjes, por presidenti Ivanov ka ndërprerë debatin dhe ka braktisur mbledhjen duke refuzuar të bisedohet për përfitimet e kësaj marrëveshjeje historike për të ardhmen e Maqedonisë", thuhet të komunikatën e Qeverisë. Me presidentin është takuar edhe lideri i opozitës, Hristijan Mickovski, pasi paraprakisht ka bërë thirrje për një takim mes tij, kreut të shtetit dhe kryeministrit.

Partitë shqiptare, nga ana tjetër, i kanë dhënë mbështetje marrëveshjes, duke e vlerësuar hap pozitiv drejt zhbllokimit shumëvjeçar të kontestit të emrit dhe hapjen e rrugës së integritit euroatlantik të vendit. Partitë shqiptare nuk kontestojnë emrin e ri Maqedonia Veriore për dallim nga i mëparshmi, kur vërejtjet e tyre kryesisht kishin të bënin me gabimet gjatë përkthimit të emrit "Maqedonia e Ilindenit". Ndryshe, pas Bashkimit Evropian dhe NATO-s, marrëveshja Maqedoni-Greqi është mirëpritur edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "SHBA-ja përgëzon kryeministrin e Maqedonisë dhe të Greqisë, Zoran Zaev dhe Alexis Tsipras, për marrëveshjen historike për zgjidhjen e kontestit për emrin. Zgjidhja do të jetë e dobishme për të dyja vendet dhe do t'i përforcojë sigurinë rajonale dhe progresin. Kryeministrat Zaev dhe Tsipras treguan vizion, guxim dhe angazhim për gjetjen e zgjidhjes së pranueshme të përbashkët", thuhet në reagimin e Departamentit amerikan të Shtetit.

Gjermania ende pa vendim për hapjen e negociatave me Shqipërinë

TIRANË, 13 QERSHOR - Qeveria gjermane ende nuk ka marrë një vendim për hapjen e negociatave me Shqipërinë, por Christian Lange, sekretar parlamentar i Shtetit në Ministrinë e Federale të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, thotë se Berlino do të shprehet në kohë për takimin e Këshillit Evropian, paraparë më 28 qershor.

Në Ekzekutivin Federal të Gjermanisë, Lange është në rangun e një zëvendësministri të Drejtësisë. Në takimin që pati me gazetaret në Tiranë, ai mohoi kur u pyet nëse çështja Tahiri është kusht për ta marrë "po"-në e



Berlini zyrtar. "Nuk është e zakonshme që rastet e veçanta të kthehen në kusht për projektet

evropiane", u shpreh Christian Lange. Lange është edhe deputet në

Bundestagun gjerman. Ai u distanca nga deklaratat e numrit dy të grupit parlamentar të CDU-

CSU-së, Waderphul, që, duke e gjykuar ministrin e Brendshëm Xhafaj në kushtet e konfliktit të interesit, kërkoi largimin e tij. Ai vuri theksin te lufta ndaj korrupsionit, fenomen për të cilin tha se i janë ankuar edhe investitorët gjermanë në Shqipëri. "Ka ende punë për të bërë dhe jemi të gatshëm të ndihmojmë, sidomos në luftën kundër korrupsionit. Korrupsioni mban peng të gjitha shtetet demokratike dhe duhet të jetë në qendër të betejës. Ai lufton demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Investitorët gjermanë që takova më sollën në vëmendje që problemi kryesor që kanë është korrupsioni", tha Lange.

Stoltenbergu: Maqedonia ka hapur rrugën drejt NATO-s

BRUKSEL, 13 QERSHOR - Konsensusi i arritur ndërmjet Athinës dhe Shkupit, rreth kontestit të emrit maqedonas, e hap rrugën drejt NATO-s. Kështu deklaroi sekretari i përgjithshëm i

Aleancës, Jens Stoltenberg, në komunikatën zyrtare të publikuar në uebfaqen e internetit të organizatës. "Një mirëseardhje për pajtimin, e arritur ndërmjet kryeministrit Tsipras dhe Zaev, pas

vendimit për zgjidhje të kontestit për emrin, e udhëhequr nga Athina dhe Shkupi. Kjo marrëveshje historike është nën durimin shumëvjeçar diplomatik dhe në vullnetin e të dyja liderëve të gjejnë

zgjidhje për kontestin, i cili tërhoqi vëmendje në rajon", thekson Stoltenbergu. Ai bëri thirrje që procesi të mbarojë dhe vendimi të formalizohet. "U bëj thirrje të dyja palëve të formalizohet

marrëveshja nga të dy liderët. Kjo do ta hapë rrugën e Shkupit drejt anëtarësimit në NATO dhe do ta forcojë paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor", vlerëson sekretari i NATO-s.



URIME FITËR BAJRAMI ! - Me Prodhime Vendore



**URIME
FITER BAJRAMI**



www.vipa-ks.com

Flet për "Epokën e re", myftiu Naim Tërnavë

Statusi juridik i bashkësive fetare

- Me rastin e festës së Fitër Bajramit besimtarëve u dëshiroj mbarësi, paqe, harmoni, dashuri dhe solidaritet



Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë, ka bërë thirrje që të zgjidhet statusi juridik i bashkësive fetare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tërnavë ka theksuar se pa arsye është duke u zvarritur statusi juridik i bashkësive fetare. Ai ka thënë se draftligji i cili tanimë është në Kuvend nuk u jep zgjidhje bashkësive fetare, megjithatë ato i vë në kuadër të ligjit. Tërnavë ka pohuar se duhet të gjendet zgjidhje që imamët dhe nëpunësit e BIK-ut të kenë pagë të pranueshme edhe të dinjitetshme. Në këtë intervistë Tërnavë ka folur edhe për sfidat me të cilat përballet institucioni që drejton. Ai ka theksuar se ndër sfidat e BIK-ut janë edukimi dhe ruajtja e besimtarëve në rrugën e drejtë, luftimi i doktrinave ekstremiste, parandalimi i dukurive negative si vetëvrasjet dhe përdorimi i narkotikëve. Tërnavë ka bërë me dije se xhamia qendrore në kryeqytet do të ndërtohet këtë vit

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 QERSHOR - "Epoka e re": Myftiu Tërnavë, si po e përmbyll Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) muajin e Ramazanit? Sa keni arritur që gjatë këtij muaji t'u dilni në ndihmë atyre që kanë pasur nevojë?
Tërnavë: Muajin e agjërimit, Ramazanin, po e mbyllim me një sërë aktivitete që Kryesia, Këshillat tanë dhe institucionet tona kanë zhvilluar në terren, ku kemi qenë së bashku me besimtarët tanë, me të cilin kemi ndarë një pjesë të konsiderueshme të këtij muaji me lutje e ibadete. Po

ashtu, gjatë aktiviteteve tona në terren kemi realizuar një projekt të cilit i ka prirë kryimami, me të cilin nëpër xhamitë tona kemi mbajtur ligjëratë tematike (vai'ze) kushtuar agjërimit të Ramazanit, pra u jemi përgjigjur interesimit të besimtarëve tanë sepse, siç dihet, gjatë këtij muaji besimtarët shtojnë dukshëm ibadet dhe janë në numër më të madh në xhami në të gjitha namazet, posaçërisht në namazin e xhumasë dhe teravive.

Përveç këtyre ne kemi organizuar edhe një sërë iftaresh anekënd vendit, ku kemi takuar qoftë strukturat tona, e më tepër

po zvarritet pa arsye



"Epoka e re": Cila është sot gjendja e myslimanëve në Kosovë dhe me çfarë sfidash është duke u ballafaquar BIK-u?

Tërnav: Gjendja e besimtarëve tanë sot është gjendje e popullit tonë. Ne jemi të vetëdijshëm se kemi një gjendje jo të mirë socio-ekonomike, kemi papunësi dhe mungesë të perspektivës për brezin e ri. Duhet të bëhet më shumë nga të gjithë që kjo situatë të ndryshojë për së miri, në mënyrë që vendi ynë të bëhet vend ku mund të jetohet me dinjitet e perspektivë, ndërsa sa iu përket sfidave me të cilat përballet BIK-u, mund të themi se kemi një sërë sfidash.

Sfida për ne janë edukimi dhe ruajtja e besimtarëve në rrugën e drejtë. Shohim dhe jemi dëshmitarë që të rinjtë tanë përballen me dukuri negative, siç janë mësimet e doktrinave ekstremiste, politizimi i fesë, pastaj dukuritë negative siç janë vetëvrasjet, përdorimi i narkotikëve etj. Ne si BIK, por edhe institucionet e tjera duhet të kujdesimi dhe të bëjmë atë që është në dorën tonë, ta edukojmë, ta fisnikërojmë dhe përgatisim rininë që mos të bie pre e doktrinave ekstreme të cilat sot janë problem në mbarë botën, dhe as mos të jenë pjesë e dukurive negative. E ardhmja jonë është rinia. Nëse kemi një rini mirë të edukuar, të ngritur dhe të arsimuar, atëherë e ardhmja jonë si shoqëri s'ka dyshim se do jetë e mirë dhe e ndritshme. Së pari, BIK-u ka telashe me sigurimin e të ardhurave personale për të punësuarit e vet. Kemi një numër të konsiderueshëm të imamëve që marrin paga minimale dhe jo me rregull. Duhet angazhim që të gjejmë zgjidhje që imamët dhe nëpunësit e BIK-ut të kenë pagë të pranueshëm dhe të dinjitetshme. Imamët janë prijës të xhematit. Nuk mund të lihen në mëshirën e askujt. Është e udhës që për ta të ndahet buxhet nga shteti. Pastaj, ende nuk është zgjidhur statusi juridik i bashkësive fetare. Mendoj se kjo po zvarritet pa arsye, ani pse edhe drafti i tanishëm që është në Kuvend nuk u jep zgjidhje bashkësive fetare, por të paktën bashkësitë fetare i bënë subjekte juridike, pra i vënë në kuadër të ligjit. Po e përsëris se ligji lëshoi shumë për të dëshiruar dhe nuk i përgjigjet realitet të Kosovës.

"Epoka e re": Krahas aktiviteteve nëpër xhami dhe medrese, kohët e fundit keni nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, ku keni ofruar në dispozicion disa imamë për të ligjruar nëpër burgjet e Kosovës kundër radikalizimit. Çfarë ndikimi do të kenë këto ligjërata?

Tërnav: Marrëveshja me Ministrinë e Drejtësisë, që imamët tanë të ligjërojnë në burgjet e Kosovës, është një marrëveshje në mes dy institucioneve që duhet parë në kuadër të koordinimit ndër-institucional për deradikalizimin dhe interpretim të drejtë të parimeve islame. Imamët tanë do t'u përgjigjen interesimit të atyre që vuajnë dënimet. Jemi të bindur se kjo do të ketë ndikim pozitiv. Aty imamët tanë do t'i shpjegojnë parimet bazike të fesë, larg mësimet e interpretimeve të ngurta e të politizuara. Këso marrëveshje është e udhës të nënshkruhen edhe me institucionet e tjera. Të gjitha institucionet duhet të bashkëpunojnë më shumë në funksion të vendit dhe të shoqërisë.

"Epoka e re": Bashkësia Islame e Kosovës dhe ju personalisht në të kaluarën keni qenë të angazhuar në lobim për rritjen e numrit të njohjeve për Kosovën. Në opinion publik sot po shihen pasiv. Pse?

Tërnav: Nuk mund të flitet për pasivitet. Kudo jemi ne, gjithëherë brenda mundësive tona llobojmë për vendin tonë, qoftë gjatë vizitave jashtë vendit apo në takimet që realizojmë këtu në Kosovë me mysafirët që takojmë. Në vazhdimësi mundohemi të jemi në shërbim të vendit.

"Epoka e re": Ka disa vjet që mediet e bëjnë të njëjtën pyetje, se kur do të nisë ndërtimi i xhamisë së madhe? Z. Tërnav, pse është duke u zvarritur kjo çështje kaq shumë, apo jeni duke u treguar të pafuqishëm si BIK?

Tërnav: Nuk flitet këtu për fuqi a pafuqi. Me kësmet, xhamia qendrore do të nisë së ndërtuari këtë vit. Jemi në fazën e fundit të përpilimit të projektit. Pasi të përfundojë projekti do të aplikojmë për leje dhe do ta nisim ndërtimin e xhamisë. E përsëris, me kësmet të Zotit, xhamia do të nisë këtë vit.

Besimtarëve u dëshiroj mbarësi, paqe, harmoni, dashuri dhe solidaritet

"Epoka e re": Myfti Tërnav, cili është mesazhi juaj për besimtarët e besimit islam me rastin e festës së Fitër Bajramit?

Tërnav: Të gjithë besimtarëve u dëshiroj mbarësi, paqe, harmoni, dashuri, respekt e solidaritet. Ramazani është muaj i sakrificës, i përkushtimit e i ibadetit. Lusim Zotin ta pranojë agjërimin tonë dhe Fitër Bajramin ta presim me gëzim e lumturi.

besimtarët tanë. Pra, kemi pasur një sërë aktivitetesh që janë realizuar me sukses. Përveç aktivitetëve tona në terren, një kujdes të veçantë ua kemi kushtuar kategorive në nevojë që, për fat të keq, te ne janë shumë. BIK-u përmes Shoqatës "Bereqeti", në koordinim me degët e veta në terren, anekënd Kosovës jemi munduar që atyre kategorive t'u dalim në ndihmë me artikuj ushqimorë dhe me veshmbathje. Gjatë Ramazanit shoqata "Bereqeti" ka ndihmuar rreth 25 mijë familje. Për këtë ndihmë u jemi mirënjohës donatorëve tanë që na mbështetën në këtë mision fisnik.

Haradinaj shpreh gatishmërinë e Qeverisë për të qenë afër komunave

"Ne kemi marrë vendime të mira dhe jemi pajtuar që komunat të jenë institucione të nivelit komunal qeverisës, vendimmarrës dhe ekzekutiv. U kemi dhënë një situatë të fuqishme vendimmarrëse komunave edhe me Ligjin për Pushtetin Lokal, edhe me atë për Zgjedhjet. Pra, komuna tek ne është shumë e fuqishme, por ajo vjen në shprehje kur vjen mundësia e zbatimit të këtyre kompetencave dhe përgjegjësi", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në konferencën jubilarë "10 vjet pas decentralizimit dhe konstituimit të qeverisjes lokale - sfidat e një dekade, rrugëtimi në dekadën e dytë", e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale.

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Kryeministri Haradinaj, në konferencën jubilarë "10 vjet pas decentralizimit dhe konstituimit të qeverisjes lokale - sfidat e një dekade, rrugëtimi në dekadën e dytë", e organizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale, duke folur për problemet me të cilat përballen komunat, ka thënë se ka mungesë të instrumenteve të komunikimit në mes të komunave dhe Qeverisë por, pavarësisht prej kësaj, ai ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë për të qenë afër komunave. Sipas tij, Qeveria duhet të ketë një ekip mobil i cili viziton komunat veç e veç dhe identifikon temat me të cilat përballen ato. "Qeveria do t'i përkrahë komunat, reformat e brendshme, të cilat komunat mund t'i nxisin edhe vetë, sepse askush më mirë se ato nuk e dinë se si mund të kryhen punët e tyre", është shprehur kryeministri, duke shtuar se duhet të ekzistojë një instrument pune në nivel qeveri - komunë.

Ndërsa Besnik Muçaj, drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale, ka thënë se viti 2018 shënon 10-vjetorin e konstituimit të qeverisjes lokale, proces ky që nisi me obligimet e Pakos së presidentit Ahtisari. "Decentralizimi i lidhur me këtë pako synonte ta promovonte konceptin e demokracisë lokale dhe akomodimin e komu-

niteteve joshumicë. Në përgjithësi, komunave me këtë proces u është dhënë autonomi e lartë, shpesh autonomi e cila në zbatim ka hasur në sfida funksionale", ka deklaruar Muçaj. Në këtë konferencë ka folur edhe ambasadori i Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad dhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet.

Konferenca ka vazhduar punimet me dy sesione, në të cilat është folur për procesin e reformave, si dhe për sfidat dhe mundësitë që kanë komunat. Të pranishëm në këtë konferencë ishin ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar, përfaqësues të Republikës së Shqipërisë, të Maqedonisë dhe kryetarë të komunave të Kosovës.

Përmes diskutimeve, rrjetëzimit dhe nismave që do të dalin nga kjo konferencë do të arrihet të sensibilizohen aktorët për rëndësinë e fuqizimit të qeverisjes, dialogut dhe demokracisë lokale; të ndikohet që niveli qendror dhe ai lokal ta kenë prioritet reformën e qeverisjes lokale, duke e bërë atë sa më efikase dhe funksionale; të kontribuohet në rritjen e shkëmbimit të informacionit, njohurive në lidhje me modelet, proceset dhe praktikën në rajon; si dhe t'i shërbejnë avancimit të agjendës së reformave evropiane.



Klinika e Kardiokirurgjisë bëhet edhe me sallën e dytë për operime

Klinika e Kirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është bërë me sallë të dytë të operimit dhe sallë të dytë të mjekimit intensiv. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se me hapjen e kësaj salle operative pritet të eliminohet lista e pritjes së pacientëve që shumë herë ka zgjatur me muaj



Kosovës. Ai ka thënë se rritja e këtij shërbimi në QKUK tregon edhe një dimension tjetër, vështirësitë që i ka pasur personeli mjekësor, duke punuar nën presione të mëdha dhe në kushte më të vështira. "Sot me investime dhe me përkrahjen e tyre kemi duke arritur të krijojmë shërbime më të shpejta dhe më cilësore për pacientët tanë", ka thënë Ismaili.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se dita e sotme është një ditë e madhe për kardiokirurgjinë dhe për krejt

shërbimet që i trajtojnë sëmundjet e sistemit kardiovaskular, duke përmbyllur një kapitull sa i përket shërbimit të kardiokirurgjisë.

"E mira në këtë klinikë ka filluar me punën 24-orëshe që nga shkurti dhe menjëherë është vërejtur se pacientët nuk kanë dalë jashtë për trajtim nga ajo periudhë, por fillimi i punës së sallës së dytë të kardiokirurgjisë dhe me kapacitete të shtuara të intensivës së dytë në kardiokirurgji rritet vëllimi i punës, krijohet siguri më e madhe, rritet performanca e mjekëve për

arsye se të gjithë pacientët do të trajtohen këtu në institucion publik që do të jetë qendër referente", ka thënë Sejdiu.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Klinikës së Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive, Tefik Bektishi, ka thënë se shërbimi i ka dy salla në kushte të shkëlqyeshme, 16 shtretër, 7 prej të cilëve në mjekimin intensiv; dy salla operative, dy të mjekimit intensiv. "Këto janë kapacitete të mjaftueshme që shumë shpejt të largohet edhe lista e pritjes", ka thënë Bektishi.

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Për vite me radhë Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka funksionuar me një sallë për ndërhyrje kirurgjike në zemër, duke krijuar lista të gjata dhe pritje me muaj për qytetarët tanë. Kjo situatë tani do të ndryshojë pasi të mërkurën është hapur salla e dytë e operacionit në Kardiokirurgji së bashku me sallën e dytë të kujdesit intensiv, duke e bërë për herë të parë QKUK-në me dy salla të tilla.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se hapja e sallës së dytë operative të Kardiokirurgjisë dhe sallës së dytë të mjekimit intensiv në këtë klinikë është një hap shumë i madh për pacientët dhe personelin mjekësor, të cilët e kanë mundësinë që tani t'u përgjigjen nevojave të tyre. Ai ka

thënë se të dy sallat janë të pajisura me aparaturë moderne dhe të gatshme për ofrimin e shërbimeve profesionale për pacientët. Sipas ministrit Ismaili, ky zhvillim do të bëjë të mundur dyfishimin e operimeve në këtë Klinikë dhe eliminimin e listës së pritjes. "Deri tani këtu është operuar me një lloj presioni për arsye se ka qenë vetëm një sallë dhe në raste urgjente pacienti është dashur të presë para se t'i krijohet mundësia që të hyjë në operacion. Tani kemi një mundësi që në dy salla të operohet dhe realisht ta mënjanojmë edhe listën e pritjes, e cila ka bërë që pacientët të cilët kanë pasur probleme me zemër të presin me vite, në mënyrë që t'i jepet shërbimi i duhur", ka thënë ministri Ismaili me rastin e përvitit të sallës së dytë të operimit dhe sallës së dytë të mjekimit intensiv në Klinikën e Kardiokirurgjisë të Qendrës Klinike Universitare të

Fondacioni Jahjaga lanson projektin për avancimin e grave në qeverisje



PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Fondacioni Jahjaga ka prezantuar të mërkurën projektin me temë "Roli i medieve në avancimin e pjesëmarrjes së grave në qeverisje", i cili është përkrahur nga ATRC dhe USAID.

Ky projekt parasheh realizimin e dy trajnimeve në fushën e avokimit dhe të folurit publik me gra në pozita udhëheqëse dhe gra nga kuvendit komunal të tri komunave (Prizren, Shtërpçë e Ferizaj), si dhe trajn-

ime me gazetarë për raportimin gjinor në mënyrë që të rritet vetëdija shoqërore për rolin e grave dhe të luftohen stereotipat gjinorë. Me këtë rast, ish-presidentja Atifete Jahjaga, në fjalën e saj hyrëse është fokusuar në rolin e gruas në pozita vendimmarrëse, duke theksuar nevojën që gratë të jenë të përfaqësuara denjësisht në politikë.

Kurse kryetarja e grupit të grave deputete në Kuvendin e Kosovës, Mexhide Mjaku-

Topalli, ka vënë në pah arritjen e barazisë gjinore si cruciale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe funksionimit të demokracisë. Ndërsa përfaqësueset e zërit të grave lokale, Kristina Gashi-Bytyçi, kryesuese e kuvendit komunal të Ferizajt dhe Sadije Jakupi, kryesuese e grupit joformal të grave në Prizren, kanë prezantuar sfidat që kanë në komunat respektive dhe vullnetin e përditshëm për avancimin e pozitës së gruas.

Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave bën thirrje për kujdes ndaj zjarreve

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) u ka bërë thirrje qytetarëve të jenë të kujdesshëm dhe vigjilentë për shmangien e të gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit dhe të lajmërojnë me kohë si dhe të ndihmojnë në shuarjen e zjarreve. "Tashmë kemi hyrë në sezonin e verës që karakterizohet me temperatura të larta të ajrit, të cilat ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zgjerimin e vullshëm të zjarreve në sipërfaqe të hapura, malore dhe fushore. Për çfarëdo rasti të zjarreve ju lutem të thirrni në Qendrën Operative Emergjente nëpërmjet numrit të integruar emergjent - 112. Gjithashtu, mund të thirrni pa pagesë edhe në

këta numra: Policinë e Kosovës në numër të telefonit 192, njësinë profesionale të zjarrfikjes dhe të shpëtimit në numrin e telefonit 193, ndihmën e shpejtë në numër të telefonit 194", është thënë në njoftimin e MPB-së, duke bërë me dije se zjarrvëniet e qëllimta si dhe ato të shkaktuara nga pakujdesia janë vepër penale dhe sanksionohen me ligj.

këta numra: Policinë e Kosovës në numër të telefonit 192, njësinë profesionale të zjarrfikjes dhe të shpëtimit në numrin e telefonit 193, ndihmën e shpejtë në numër të telefonit 194", është thënë në njoftimin e MPB-së, duke bërë me dije se zjarrvëniet e qëllimta si dhe ato të shkaktuara nga pakujdesia janë vepër penale dhe sanksionohen me ligj.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është pritur në takim nga raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën, Tanja Fajon

Fajoni: Kosova ka përmbushur kriteret, liberalizimi gjatë këtij viti

Kosova tashmë ka përmbushur të gjitha kriteret dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë gjatë këtij viti. Kështu ka deklaruar të mërkurën raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën, Tanja Fajon, gjatë takimit me kryeparlamentarin Kadri Veseli. Ky i fundit ka theksuar se tanimë Kosova në këtë proces ka nevojë vetëm për vendimmarrje politike

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, të mërkurën është pritur në takim nga raportuesja për liberalizimin e vizave për Kosovën, Tanja Fajon, me të cilën ka diskutuar rreth zhvillimeve aktuale në vend dhe rajon, për procesin e integritimeve si dhe për liberalizimin e vizave. Me këtë rast, raportuesja Fajon ka thënë se Kosova tashmë ka përmbushur të gjitha kriteret dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë gjatë këtij viti. Ajo ka bërë me dije se sapo Komisioni Evropian të dalë me raport pozitiv në fund të qershorit, menjëherë në fillim të korrikut do të hyjë në agjendën e Komisionit të liberalizimit të vizave çështja e

Kosovës. "Jam e lumtur që po e takoj kryetarin e Kuvendit të Kosovës për t'i diskutuar hapat e ardhshëm për liberalizim të vizave. Përkrahja ime është e paekuivokë, sepse qytetarët e Kosovës meritojnë të udhëtojnë pa viza në Zonën Shengen", ka deklaruar Fajon.

Ndërsa kryeparlamentari Kadri Veseli ka konfirmuar përkushtimin e institucioneve dhe të popullit të Kosovës për të ecur më shpejt në proceset e integritimit evropian, por ka theksuar domosdoshmërinë që edhe Bashkimi Evropian të lëvizë përpara në raport me Kosovën dhe qytetarët e saj, veçanërisht lidhur me heqjen e vizave gjatë këtij viti. "Zonja Fajon është duke bërë një punë jashtëzakonisht pozitive, në mënyrë që liberalizimi i vizave për qytetarët tanë të ndodhë. Analizuaam realitetin në të cilin

jemi. Pothuajse jemi në fazën përfundimtare. Të gjitha kushtet teknike janë plotësuar. Tani kemi nevojë vetëm për vendimmarrje politike. Jam i sigurt që në fund të këtij viti

qytetarët tanë do të lëvizin lirshëm pa viza në Zonën Shengen. Zonja Fajon më këshilloi se në cilat vende duhet të orientoheja, për t'i bindur ato lidhur me liberalizimin e vizave. Jemi në prag të vendimit të madh", ka thënë Veseli.

Po në vazhden e vizitës në Strasburg, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, të mërkurën ka zhvilluar takime të ndara me eurodeputetë të forcave të ndryshme politike, njëherësh raportues për vende të ndryshme të Ballkanit nga të cilët ka marrë mbështetje për heqjen e vizave për Kosovën.

Veseli në Parlamentin Evropian ka mbajtur takime të veçanta me zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, me kryesuesin e AFET, njëherësh raportues për Serbinë, David McAllister, udhëheqësin e delegacionit për BiH dhe Kosovë, Tonino Picula, udhëheqësin e grupit politik Social Demokrat (S&D) në Parlamentin Evropian, Udo Bullmann.

Në këto takime është diskutuar për proceset nëpër të cilat po

kalon Kosova në rrugën drejt integritimeve evropiane, me fokus angazhimet e institucioneve në procesin e liberalizimit të vizave. Më pas, kryeparlamentari Veseli ka mbajtur takime edhe me eurodeputetët Andrey Kovatchev, Asim Ademov dhe me Angel Dzambaski. Me këtë rast Veseli i ka njoftuar eurodeputetët për arritjet e Kosovës në shumë fusha dhe për përkushtimin institucional për ta çuar përpara perspektivën euroatlantike. Edhe në këtë takim kreu i Kuvendit të Kosovës ka theksuar se populli i Kosovës pret që brenda vitit t'i mundësohet lëvizja e lirë në Zonën Shengen.

Kurse anëtarët e Parlamentit Evropian kanë shprehur kënaqësinë për përparimet në Kosovë dhe falënderuan kryeparlamentarin Veseli për vizitën në Strasburg, si dhe për prezantimin e përparimeve që ka shënuar Kosova në rrugën e reformave evropiane, me theks të veçantë në përmbushjen e gjitha kriterëve për liberalizimin e vizave.



Të premtën dita e parë e Fitër Bajramit

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka njoftuar opinionin, se muaji i madhëruar i Ramazanit përfundon ditën e enjte, ndërsa dita e parë e festës së Fitër Bajramit është të

premtën. "Manifestimi qendror për festën e Fitër Bajramit për Republikën e Kosovës mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Manifestimi fillon në orën 04:10, me faljen e namazit të sabahut, pas të cilit

do të jetë ligjërata tematike kushtuar kësaj feste nga drejtori i Medresesë, Jakup ef. Çunaku. Namazi i Fitër Bajramit falet në orën 05:34 minuta të cilit do t'i prijë, Resul ef. Rexhepi, sekretar i

përgjithshëm i BIK-ut", është thënë në njoftimin e BIK-ut. Hytben e Fitër Bajramit do ta mbajë myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili do t'i drejtohet opinionit të gjerë me mesazh për këtë festë.



Kosova përfiton nga Gjermania tetë milionë euro grant



PRISHTINE, 13 QERSHOR (ER) - Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e përfaqësuar nga Banka Zhvillimore Gjermane (KfW), të mërkurën nënshkruan marrëveshjen financiare të grantit për projektin "Mënjanimin e ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore - faza V". Në praninë e ambasadorit të

Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Financave, Bedri Hamza, dhe nga udhëheqësi i zyrës së KfW Rene Eschemann në emër të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW.

Ministri Hamza ka thënë se është i lumtur që sot si Qeveria e Kosovës nënshkruam marrëveshjen "Mënjanimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore - faza V" për Prizrenin, Pejën dhe

Gjakovën me Qeverinë Gjermane. Ai gjatë takimit ka theksuar se Gjermania ka dhënë për Kosovën 86 milionë euro, ku 50 % të tyre janë në formë të granteve, ndërsa kjo është marrëveshje e cila e ngrë shumë e marrëveshjeve që janë në formë të grantit, kontribut financiar pa kthim. "Nga këto 86 milionë euro, 50 % me marrëveshjen që nënshkruam sot janë grante, donacione të institucioneve të Gjermanisë, gjë për të cilat e

falënderojmë ambasadorin, institucionet gjermane dhe taksapaguesit gjermanë që po kontribuojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës", ka thënë ministri Hamza.

Kjo është faza e pestë për investime në fabrikat e këtyre qyteteve për trajtimin e ujërave të zeza, të cilat fabrika janë ndërtuar me ndihmën e Qeverisë gjermane përmes granteve. Kjo marrëveshje është nënshkruar për t'i avancuar edhe më tutje këto investime të

bëra deri më tani.

Marrëveshje e nënshkruar të mërkurën ka të bëjë me vendosjen e kamerave nëpër rrjete për këto komuna për identifikimin e nevojave për investime, pastaj këto të dhëna vendosen në sistemin GIS (Sistemin Informativ Gjeografik), ku në të ardhmen, me investim tashmë të zotuar të Qeverisë Gjermane, do të mundësohet edhe ndarja e ujërave të zeza nga ujërat atmosferikë.

Zëvendësministri Dukolli vizitoi kompaninë 'Sharrcem'

HAN I ELEZIT, 13 QERSHOR (ER) - Zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Çerkin Dukolli, i cili njëherësh është edhe kryesues i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, të mërkurën ka vizituar fabrikën e çimentos "Sharrcem" në Han të Elezit. I shoqëruar nga anëtarët e Këshillit, ata u njohën nga afër me masat mbrojtëse dhe preventive që aplikohen në "Sharrcem" për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Zëvendësministri Dukolli ka pohuar se në kuadër të planit dyvjeçar të punës dhe vizitave të planifikuara nëpër kompani të ndryshme, KNSSHP-ja jorastësisht ka përzgjedhur "Sharrcem"-in. "Siguria dhe shëndeti në punë është çështje që na shqetëson të gjithëve. Në këto vizita ne po informohemi drejtpërdrejt nga



punishtet me kushtet dhe ambientin e punës së punëtorëve, në veçanti me aspektin e sigurisë

dhe shëndetit në punë", ka thënë ai.

Dukolli ka shtuar se kjo praktikë

do të vazhdojë edhe në kompani të tjera jo vetëm sa për ta skanuar gjendjen, por do të nxirren kon-

kluzione përafërsisht të sakta se si të veprohet tutje, qoftë edhe si shkëmbim përvojash, duke afirmuar shembujt e mirë të biznesit për aplikimin e masave preventive për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në vendet e punës. Ndërkaq drejtori menaxhues në "Sharrcem", Thomas Galvas, ka deklaruar se menaxhmenti i kompanisë po bën maksimumin në fushën e sigurisë. Ai e ka njoftuar zëvendësministrin Dukolli se duke aplikuar praktikën më të mirë të sigurisë dhe të shëndetit në punë. Në "Sharrcem" në dy vjetet e fundit nuk është raportuar asnjë lëndim në punë. Galvas ka theksuar se menaxhmenti i kompanisë është i hapur për bashkëpunim dhe se komentet apo sugjerimet e ndryshme në fushën e sigurisë janë të mirëseardhura.

Vetëvendosja: Vendimi për rritje të pagave është kundërkushtetues

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka thënë se vendimi i Qeverisë Haradinaj për rritje të pagave, përpos që është vepër penale, është edhe kundërkushtetues, pasi ka ndërhyrë në kompetencat e Kuvendit

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur të mërkurën konferencë për media në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese mbi vendimin e Qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave.

Anëtarja e Kryesisë, njëherësh deputete, Albulena Haxhiu, ka folur për shkeljet kushtetuese që ka bërë vetë trupi i kësaj gjykate kur e ka nxjerrë vendimin se ngritja e pagave nuk e cenon Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Në vend se Gjykata Kushtetuese ta ndalonte abuzimin me parane publike, gjyqtarët si Arta Rama-Hajrizi, Ivan Cukalovic, Allta Suroy, Snezhana Botusharova, Bekim Sejdiu, Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, përmes këtij vendimi mundësuan ngritjen e pagave edhe për vete. Aktgjykimin e Gjykatës, se rritja e pagave nga Qeveria për vetë Qeverinë dhe stafet e tyre është brenda normës kushtetuese, tregon më shumë për karakterin në të cilin është zhytur trupa e gjyqtarëve sesa për vetë vendimin", ka thënë deputetja Haxhiu.

Duke folur për këtë vendim dhe rrethanat e një shteti të kapur, ajo ka theksuar se ky veprim po ashtu i shërben konjunkturës së pushtetit duke konstatuar se shumica e gjyqtarëve të Kushtetueses u shndërruan në rojtarë të kësaj konjunkturë duke shpërfillur detyrën e mbrojtjes së Kushtetutës si kohezion shoqëror. "Vendimi i Qeverisë Haradinaj për rritje të pagave, përpos që është vepër penale, është edhe kundërkushtetues, pasi ka ndërhyrë në kompeten-

cat e Kuvendit. Këtë e dëshmon edhe qëndrimi mospajtuës i dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gresa Caka - Nimani dhe Almiro Rodriguez", ka thënë Haxhiu.

Ndërkaq Avni Zogiani ka krahasuar pagat e kryeministrave të vendeve të rajonit karshi pagës mesatare të këtyre vendeve përkatëse që tregojnë se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkundër që ka varfëri e pabarazi të madhe sociale, i ka pagat më të larta në rajon. "Sipas shifrave të vitit 2017, paga mesatare në Mal të Zi është 509 euro, ndërkaq kryeministri i këtij shteti paguhet 1 130 euro. Në Bosnjë paga mesatare është 439 euro, kurse ajo e kryeministrit 1 700 euro, duke vijuar tutje me Maqedoninë, ku mesatarja është 372 euro dhe ajo e kryeministrit 1 300 euro, në Serbi 407 euro mesatarja dhe 1 000 euro paga e kryeministrit, në Shqipëri 347 euro paga mesatare krahasuar me atë të kryeministrit që merr 1 700 euro. Ndërsa kryeministri i Republikës së Kosovës ka pagën 2 950 euro përkundër pagës mesatare që është 405 euro (sipas disa të dhënave, edhe më e ulët)", ka thënë Zogiani.

Ai ka shtuar se autoriteti që merr vendime në Republikën tonë lidhur me pagat është Kuvendi përmes Ligjit për Buxhetin dhe Ligjit për pagat. "Por, jo vetëm kaq. Vendimi për rritje të pagave është edhe shkelje e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për shkak se kjo rritje nuk është paraparë me buxhetin për vitin 2018. Ligji i Buxhetit 2018 ka paraparë vetëm rritjen e pagave 4 % për të gjithë të punësuarit që paguhen nga buxheti i shtetit", është shprehur ai.



Zogiani ka theksuar se në bazë të përlllogaritjeve të ekspertëve të Lëvizjes Vetëvendosje ky vendim ka implikime buxhetore prej 6 deri në 7 milionë euro, që do të thotë se një pjesë e parave

do të merren nga kategoritë e tjera buxhetore, mirëpo ky vendim nuk do të mund të merret pa vendim nga Kuvendi. Gjatë kësaj konference për medie u bë me dije se Lëvizja

Vetëvendosje ka nisur ta hartojë kallëzimin penal për kryeministrin dhe ministrat që kanë marrë pjesë në votim, përfshirë edhe gjyqtarët e Kushtetueses të cilët rritën edhe pagat e veta.

LB-ja: Qeveria Haradinaj, e papërgjegjshme ndaj parasë publike

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konstatuar se ngritja e pagave nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, ka reaguar edhe Lëvizja për Bashkim (LB). Sipas kësaj partie, ky veprim i Qeverisë ka shqetësuar opinionin publik dhe ka dëshmuar për një qasje arrogante që ka kjo Qeveria në të gjitha drejtimet. "Lëvizja për Bashkim konsideron se Qeveria, para se të vendoste për zbatimin e këtij vendimi,

do të duhej të reflektonte lidhur me reagimin e opinionit publik për këtë çështje. Ajo, së paku, nuk do të duhej të ndërmerre këtë hap para se ta draftonte Ligjin për Qeverinë në të cilin do të kufizohej numri i ministrave, këshilltarëve e sidomos zëvendësministrave. Mos të harrojmë se kjo Qeveria, në mënyrën më të papërgjegjshme, ka shtuar në rreth 80 numrin e zëvendësministrave, të cilët, përveç barrës financiare, janë edhe

pengesë në efikasitetin e punës së ministrave. Gjithashtu, do të duhej të pritej edhe miratimi i Ligjit për Pagat që është në procedurë, i cili do të vendoste bazat edhe për pagat e stafit politik", është thënë në reagimin e Lëvizjes për Bashkim. Sipas LB-së, ky vendim është i papranueshëm, pasi Qeveria Haradinaj vendosi t'i rrisë pagat mbi nivelin e pagave të rajonit dhe në s'përputhje të plotë me situatën socio-ekonomike të vendit.

AVUK-u: Nuk ka dyshime për cilësinë e biskotave 'Plazma'



PRISHTINË, 13 QERSHOR - Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit e Kosovës (AVUK) ka bërë kontrollin e biskotave "Plazma" me orgjinë nga Serbia, të cilat eksportohen në Kosovë dhe që, ditë më parë, u cilësuan si produkt i dyshimtë. Lamir Thaçi, zëdhënës në AVUK, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se dyshimet që janë paraqitur në Slloveni, në lidhje me cilësinë e produktit "Plazma", nuk kanë bazë në Kosovë. "Pas rapor-

timeve nga shteti i Sllovenisë se ka pasur dyshime rreth përmbajtjes së biskotave 'Plazma' me orgjinë nga Serbia, ne menjëherë kemi ngritur nivelin e kontrollit. Kemi marrë informatat e biskotave që kanë qenë me probleme në Slloveni dhe pas verifikimeve të ngarkesave dhe kontrolleve që i kemi kryer tek operatori importues i këtij produkti, kemi vërtetuar se biskotat që kanë qenë të dyshimta nuk janë të pran-

ishme në Kosovë", ka thënë Thaçi, duke shtuar se, përveç këtij kontrolli që kanë bërë, AVUK-u ka kryer kontrolle edhe të produkteve të tjera që janë me këtë lloj produkti. "Sa iu përket të dhënave, gjithçka është në rregull", ka bërë me dije Thaçi. Përgjegjës në kryesore për kontrollin e ushqimit në Kosovë e ka Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit e Kosovës si autoritet shtetëror.

MEKA
HALAL FOOD

Me fat festa e
Fitër Bajramit!



MADE IN KOSOVA
është më e mira ✓



www.meka-mish.com

Maqedonia, emri i ri: Nocioni gjeografik më i mirë se historik



Lisen BASHKURTI

Pas një bllokimi të gjatë nga Greqia të procesit të integritetit të Maqedonisë në NATO dhe BE për shkak të debatit për emrin duket se zgjidhja erdhi. Negociatat e shumta e mjaft kontroverze përfunduan me emrin "Republika e

Maqedonisë Veriore". Është një përcaktim me nocion etnogeografik.

Kalvari i debateve duket se ka qenë rreth nocionit që do të formulohej emri i ri. Ka pasur dy grupe propozimesh: një grup emrash me nocione thjeshtë historike dhe një grup emrash me nocione thjeshtë gjeografike. Emrat me nocione thjeshtë historike duket se kanë bartur ngarkesa etno-historikokulturore me shumë ambiguitete, të papranueshme kryesisht nga pala greke. Emrat me nocione thjeshtë gjeografike kanë zbehur deri në fshirje identitetin etno-historik-kul-

turor dhe si të tillë janë hedhur poshtë gjatë bisedimeve nga pala maqedonase.

Zgjidhja erdhi si rezultat i kompromisit midis dy grupe emrash, të atyre historikë dhe gjeografikë së bashku. Ky emër kompromisi duket se kënaqë më së shumti të dyja palët: pala maqedonase ndjen të realizuar identitetin historik-kulturor (në pjesën e emrit 'e Maqedonisë'), ndërsa pala greke ndihet e kënaqur sepse ka arritur ta ruajë identitetin antik të Maqedonisë, duke e lokalizuar gjeografikisht (në pjesën e emrit 'Veriore'). Të dyja palët kanë lëshuar diçka

nga vetja për t'ia dhënë palës tjetër, sikundër kanë fituar diçka për vete duke ia kufizuar palës tjetër. Zgjidhja duket të jetë e arsyeshme. Tipike formulë negociatash, ku asnjëra palë nuk fiton gjithçka, por edhe nuk humbet gjithçka. Është një rezultat win-win. Ose një fitore pa të humbur.

Edhe nga përvoja historike e diskurseve politiko-diplomatike për emrat e shteteve praktika e përcaktimit etnike, e mpleksur me nocione gjeografike, ka qenë më e gjendur, më e pranueshme dhe, si rrjedhojë, më e qëndrueshme. Kështu kemi emrat e Koresë së

Veriut, të Timorit Lindor etj., që janë përdorur në rrethana specifike, por në mënyrë të qëndrueshme.

Pas arritjes së kompromisit për emrin, Republikës së Maqedonisë Veriore i hapet rruga për të hedhur dy hapa të mëdhenj drejt integriteteve euroatlantike: anëtarësimin të plotë në NATO dhe hapjen e negociatave për anëtarësim në BE.

Në të dy këto dimensionet të integritetit avancimi i Republikës së Maqedonisë Veriore është me dobi të madhe për vendin dhe për mbarë Ballkanin Perëndimor.

Reshitaj merr përkrahje nga Avokati i Popullit për zgjidhjen e problemeve mjedisore

PRISHTINE, 13 QERSHOR (ER) - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka pritur të mërkurën në takim Avokatin e Popullit, Hilmi Jashari, me të cilin diskutuan për thellimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve.

Ministria Reshitaj e ka përgëzuar avokatin për punën që është duke e bërë dhe ka falënderuar atë për bashkëpunimin në adresimin e problemeve që lidhen me mjedisin, shëndetin e mirëqenien e qytetarëve. Reshitaj e ka njoftuar avokatin e popullit me projektet dhe veprimet e saj në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, duke vlerësuar se duke mbajtur

mjedisin e pastër, duke luftuar ndotjen e ujit, tokës e ajrit në mbrojmë të drejtave elementare të të drejtave të njeriut.

Ndërsa Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka vlerësuar përkushtimin e ministres për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, duke theksuar rëndësinë e ndërjegjësimit të qytetarëve mbi rëndësinë që ka një mjedis i pastër. Ai ka ofruar përkrahjen e rezervë për ministrin Reshitaj për reduktimin e ndotjes së ajrit, tokës, burimeve ujore, liqeneve si dhe për zbatimin e kornizës ligjore që lidhet me mjedisin si hap shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për arritjen e progresit në fushën e mjedisit.



Bytyqi: Ideali i dëshmorëve, të kemi një rini të arsimuar

PRIZREN, 13 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë në ceremoninë e përmbylljes së manifestimit "Java e Remzi Ademaj" në Prizren, aktivitet ky që është zhvilluar për disa ditë në frymë të garave të ditorisë, sporteve dhe aktiviteteve kulturore-artistike. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka përgëzuar organizatorët e kësaj ngjarjeje, duke thënë se shpërblymi dhe nderimi më i madh për

dëshmorët tanë është që të zhvillohen aktivitete të tilla në frymën e edukimit, kulturës dhe sportit. "Ideali i dëshmorëve tanë ishte të kemi një rini, e cila duhet të edukohet dhe arsimohet në liri, një rini të shëndetshme, e cila do t'u prijë proceseve zhvillimore, të ardhmes së vendit", ka thënë Bytyqi.

Duke iu uruar suksese të mëtejme nxënësve pjesëmarrës në këtë aktivitet, ministri Bytyqi ka bërë me dije se MASHT-i do të vazhdo-

jë ta promovojë frymën garuese pozitive në shkollat tona, të nxitet dhe motivohen arritjet e rezultateve të mira në arsim, duke i shpërblyer nxënësit, mësuesit dhe shkollat më të mira. Në ceremoninë përmbyllëse të këtij manifestimi kushtuar dëshmorit të kombit Remzi Ademaj, emrin e të cilit e mban shkolla e mesme e lartë në Prizren, garuesve më të mirë iu ndanë mirënjohje nga Drejtoria Komonale e Arsimit në Prizren.



Begaj së bashku me vëllezër e ndërton një shtëpi në Malishevë

MALISHEVË, 13 QERSHOR (ER) - Ka filluar ndërtimi i shtëpisë për familjen e Mustafë Hoxhës nga Bellanica. Ndërtimi i shtëpisë është mundësuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe vëllezërit e tij, pasi kryetari Begaj ka ndarë 1 000 nga paga e tij

mujore, ndërsa dy vëllezërit e tij kanë ndarë po nga 1 000 euro nga buxheti familjar për ndërtimin e shtëpisë për familjen Hoxha.

Kryetari Begaj të mërkurën e ka vizituar këtë familje, duke parë nga afër fillimin e punimeve, ndërsa i ka premtuar familjes Hoxha se,

pavarësisht se sa do të kush-tojë ndërtimi i shtëpisë, ajo do të ndërtohet edhe nëse nuk mjaftojnë këto mjete, pasi vëllezërit e tij kanë shprehur gatishmërinë për ndërtimin e shtëpisë. Ndërsa Mustafë Hoxha e ka falënderuar kryetarin dhe familjen Begaj për ndihmën e dhënë.





vala
KOSOVO TELECOM

TELEKOMI I KOSOVËS URON BESIMTARËT ISLAM
ME FAT FITËR BAJRAMI

www.kosovotelecom.com



PRISHTINA INTERNATIONAL AIRPORT ADEM JASHARI

Limak
KOSOVO

*Me Fat
Fitër Bajrami!*

REPUBLICA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

PASAPORTË
ПАСОПОРТ
PASSPORT

Me fat Fitër Bajrami!

IPKO ju uron të gjithë besimtarëve musliman festën e shenjtë të Fitër Bajramit.



Edhe Mitrovica përfshihet në 'Projektin Socio'

MITROVICË, 13 QERSHOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik, Ekrem Sadiku, kanë pritur në një takim Artan Gota, koordinator në Projektin "Stabiliteti socio-ekonomik i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë", i njohur edhe si "Projekti socio", që është një nismë e financuar nga "Engagement Global", në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim - BMZ.

Projekti është duke u implementuar nga Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik-PREDA Plus Kosovë, në partneritet me Arbeiter Samariter Bund-ASB.

Koordinatori Artan Gota ka theksuar se projekti ka për qëllim krijimin e vendeve të punës dhe mundësive të gjenerimit të ardhurave, fuqizimin e kapaciteteve të shoqatave bujqësore dhe atyre të biznesit në dy segmente si dhe krijimin e mundësive për zhvillimin e komunitetit.




Sot përrurohet segmenti i tretë i autoudhës R6 'Arbën Xhaferi'

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Sot (e enjte) Ministria e Infrastrukturës do ta mbajë ceremoninë e përrurimit të segmentit të tretë (i parafundit) të autoudhës R6 "Arbën

Xhaferi", Prishtinë - Hani i Elezit. Përrurimi këtij segmenti do të mbahet nën moton e kampanjës "Jo shpejtësisë, po sigurisë", e cila ka për qëllim vetëdijesimin e ngasësve të

automjeteve dhe rritjen e sigurisë në trafik. Ceremonia e përrurimit të segmentit të tretë do të mbahet në kycjen "Dogana" (Kaçanik), me fillim nga ora 11:00.



Pritet shpronësimi i tokave në Zonën e Parkun Industrial në Prizren

PRIZREN, 13 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës do ta nënshkruajë kërkesën e kësaj komune për shpronësimin e tokave në zonën e Parkut Industrial. "Ky është lajm jashtëzakonisht i mirë për Prizrenin ngaqë hap rrugën për finalizimin e këtij projekti i cili është zvarritur për një dekadë

të tërë. Komuna e Prizrenit ka shumë nevojë për Park Industrial, për faktin se do ta mundësojë ofrimin e hapësirës për investime vendore dhe të huaja dhe për faktin se Prizreni ka traditë më të gjatë të industrializimit në vend", ka thënë Haskuka. Ai ka deklaruar se hapja e këtij parku do të ketë ndikim në uljen e papunësisë. "Prizreni ka prodhuar armë të

ndryshme, produkte dekorative të arit e argjendit, si dhe ka qenë i shquar për përpunimin e lëkurës. Të gjitha këto produkte, qysh para disa shekujsh, janë shitur gjithandej në Evropë dhe në vendet e Mesdheut. Hapja e Parkut Industrial mundëson hapjen e vendeve të reja të punës dhe rikthimin e traditës industriale në qytet", është shprehur Haskuka.

Në Ferizaj mbahet debati për tri projektligjet e administratës shtetërore

FERIZAJ, 13 QERSHOR (ER) - Ministria e Administratës Publike, në bashkëpunim me OJQ Iniciativa për Progres (INPO), kanë mbajtur debat publik konsultativ në Ferizaj për pakon e ligjeve të reformës së administratës shtetërore, përkatësisht për Projektligjin për administratën shtetërore, atë për zyrtarët publikë si dhe Projektligjin për pagat.

Në këtë debat publik morën pjesë kryetarët dhe nënkryetarët e komunave të rajonit të Ferizajt, Komuna e Kaçanikut, Hanit të Elezit, Shtimes dhe Shtërpcës.

Në hapjen e këtij debati publik Albulena Ndrecaj, drejtoreshë e INPO-s, ka thënë se këto tri projektligje kanë një rëndësi të

veçantë për reformimin dhe modernizimin e administratës publike. Ndërsa kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se kjo komunë shquhet për reforma në administratë. "Administrata është sfidë kudo në botë, është sfidë në shtetet demokratike, madje shpesh nuk mund të gjendet ai çelësi magjik për t'i bërë ligjet më adekuate sa iu përket reformave më të mira të administratës", ka thënë Aliu. Ai ka shtuar se politikat administrative në nivel lokal tashmë me këtë pako ligjore do ta kenë mbështetjen e duhur ligjore. Po ashtu, Aliu ka folur edhe për koeficientin e pagës për punonjësit e gjendjes civile për të cilin ka thënë se është i ulët.



Me Fat Fitër Bajrami



Rusia: NATO-ja po kërcënon sigurinë evropiane

MOSKË, 13 QERSHOR - Rusia tha se plani i ri i NATO-s për ta rritur gatishmërinë e saj ushtarake në Evropë do ta dobësojë sigurinë në kontinent dhe paralajmëroi se Moska do ta marrë parasysh atë në planifikimin e vet

ushtarake. Zëvendësministri i Jashtëm rus, Aleksandr Grushko, e kritikoi nismën e njohur si "Katër/tridhjetë" në komentet e bëra të mërkurën. Ai tha se Rusia do t'i marrë të gjitha masat e

nevojshme ushtarake për ta garantuar sigurinë e saj. "Nisma krijon kërcënim për sigurinë evropiane", tha Grushko. "Katër/tridhjetë", nismë që u mbështet nga ministrat e mbrojtjes të NATO-s në

takimin më 7 qershor, synon t'i mbrojtë aleatët nga, siç thuhet, kërcënimet në rritje të Rusisë dhe ta forcojë gatishmërinë luftarake, duke lehtësuar transportin e trupave anembanë Evropës, në rast krize.



Trumpi: Pheniani nuk përbën më kërcënim bërthamor

Presidenti amerikan Donald Trump, pas kthimit në Uashington, pas takimit të nivelit të lartë në Singapor me udhëheqësin e Koresë së Veriut Kim Jong Unin, deklaroi se Koreja e Veriut nuk përbën më kërcënim bërthamor



Çarmatimi bërthamor i Koresë së Veriut, brenda dy vjetëve

UASHINGTON, 13 QERSHOR - ShBA-ja ka shumë shpresa që pjesa më e madhe e çarmatosjes bërthamore të Koresë së Veriut mund të kryhet deri në fund të mandatit presidencial të Donald Trumpit.

Shefi i diplomacisë amerikane, Mike Pompeo, deklaroi në Seul se "çarmatimi bërthamor i Koresë së Veriut mund të bëhet në dy vjet e gjysmë". Ai garantoj para gazetarëve se denuklearizimi i plotë i Gadishullit Korean, në favor të të cilit u angazhua të martën Kim Jong Unin gjatë samitit të tij me presidentin amerikan, përfshin karakterin e tij të verifikueshëm dhe të pakthyeshëm, sikurse e kërkon ShBA-ja.

Administrata amerikane është kritikuar nga shumë ekspertë, sepse këta dy terma nuk figurojnë në tekstin e përbashkët të nënshkruar nga dy personalitetet.

UASHINGTON, 13 QERSHOR - Presidenti amerikan Donald Trump deklaroi të mërkurën se Koreja e Veriut nuk përbën më kërcënim bërthamor, ndërsa u kthye në Uashington pas takimit të nivelit të lartë në Singapor me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Unin. "Të gjithë tani mund të ndihen shumë më të sigurt se ditën kur unë mora detyrën", shkruante Trumpi në një postim në "Twitter". "Takimi me Kim Jong Unin ishte një përvojë interesante dhe shumë pozitive. Koreja e Veriut ka një potencial të madh për të ardhmen!", ka shkruar presidenti.

Gjatë takimit të martën udhëheqësi i Phenianit u pajtua "për çarmatimin bërthamor të Gadishullit Korean", ndërsa presidenti Trump njoftoi papritur pezul-

limin e stërvitjeve ushtarake me Korenë e Jugut.

Dokumenti i nënshkruar nga dy udhëheqësit nuk përfshin detaje se si dhe kur Koreja e Veriut do ta nisë procesin e çarmatosjes bërthamore, as nuk qartëson se çfarë garancish sigurie do t'i japin Shtetet e Bashkuara, Koresë së Veriut.

Kritikët vunë në dukje mungesën e detajeve në marrëveshje duke vënë në pikëpyetje nëse Trumpi ofroi shumë duke marrë shumë pak si shkëmbim gjatë bisedimeve me udhëheqësin e Phenianit.

Presidenti Trump e ka mbrojtur marrëveshjen si një hap të madh në trajtimin e kërcënimit që vjen nga një Kore e armatosur me armë bërthamore. Ai tha se beson se Qeveria e Kim Jong Unin do ta nisë menjëherë procesin e realizimit së marrëveshjes.

BE-ja trefishon buxhetin e saj për sigurinë në kufij

Bruksel, 13 qershor - Bashkimi Evropian do të vendosë një trupë prej 10 mijë rojash në patrullimin e kufijve të saj tokësorë dhe detarë sipas planeve që do të bëjnë që blloku të trefishojë deri në pesë miliardë euro në vit shpenzimet e tij për vënien në shënjestër të emigracionit në bllok.

Ndërtimi i infrastrukturës së re në kufi, përfshirë skanerë, sisteme automatike të njohjes së targave të automjeteve dhe laboratorë të lëvizshëm për analiza, do të jetë prioritet bashkë me patrullimet me qenë të trajnuar.



Duke publikuar planin e tij të shpenzimeve prej 34.9 miliardë dollarësh, për vitet 2021-2027, Komisioni

Evropian insistoi se nuk do ta financonte vendosjen e rrethimeve në kufijtë e BE-së. Kryeministri djathtist

i Hungarisë, Viktor Orban, vitin e kaluar i kërkoi BE-së ta financonte rrethimin në kufijtë e vendit të tij me Serbinë dhe Kroacinë.

Një deklaratë e Komisionit theksoi se financimi i tij kishte si qëllim ta siguronte kontrollin e kufijve dhe jo mbylljen e tyre. Komisioni nuk ka financuar asnjëherë rrethimet në kufi dhe nuk do ta bëjë këtë edhe me buxhetin e ri të BE-së. Frans Timmermans, zëvendës-president i komisionit, tha se, bazuar në përvojën e shkuar dhe faktin që emigracioni do të mbetet një sfidë në të ardhmen, propozojnë rritje të

paprecedentë në financime. Fuqizimi i kufijve të përbashkët të BE-së do të vazhdojë të jetë një prioritet i madh. Edhe pse financimi shtesë është gjerësisht i pranuar nga shtetet anëtare, ato mbeten të ndara në lidhje me emigracionin dhe politikën e azilit, edhe pas dy vjetësh përplasje. Komisioni do të nxjerrë Poloninë, Hungarinë dhe Republikën Çeke para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për faktin se ato nuk kanë respektuar sistemin e kuotave të detyrueshme që synonte të sistemonte rreth 120 mijë refugjatë sirianë.


Egjipti, më i sigurt sesa SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar

KAJRO, 13 QERSHOR - Egjipti, në një anketë globale, u rendit si vendi më i sigurt në Afrikë dhe, madje, më lart se Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar. Qendra Gallup i ka pyetur

njerëzit nëse ndihen të sigurt të ecin natën rrugës dhe nëse kanë qenë viktimë të krimit. Anketa e radhit Egjiptin të 16-in në mesin e 135 vendeve, ndërsa Mbretëria e Bashkuar ndod-

het në pozitën numër 21 dhe ShBA-ja në 35. Singapori, ndërkaq, radhitet si më i sigurti, ndërsa Venezuela është në fund të listës. Presidenti i Egjiptit, Abdul Fattah al-Sisi, e

udhëheq këtë vend prejse ushtria ka hequr nga detyra presidentin pro-islamik, Mohammed Morsi, në vitin 2013. Qeveria e tij vazhdon t'i luftojë militantët e Shtetit Islamik në disa rajone.



Rita Ora tërheq vëmendjen



Rita Ora ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve në Nju Jork me veshjen blu. Këngëtarja me origjinë shqiptare u shfaq në eveni-

mentin e TrevorLive NY në Ciprani, ku ishte e ftuar për të performuar. Me flokët e saj portokalli 27-vjeçarja dukej mahnitëse.



Angelina mund ta humbë kujdestarinë e fëmijëve


Angelina Jolie është urdhëruar ta lejojë ish-bashkëshortin e saj Brad Pitt të kalojë më shumë kohë me fëmijët e tyre, përderisa ish-çifti janë në mesin e negociatave për divorc. Jolie, 43-vjeçare, ka kujdestarinë primare të gjashtë fëmijëve të tyre. Një gjykatëse ka këshilluar Jolien të lejojë Pittin, 54-vjeçar, t'i vizitojë fëmijët rregullisht përgjatë verës përderisa aktorja është në xhirimet



e "Maleficent 2". Në qoftë se Jolie nuk u përmbahet rregullave të caktuara nga gjykata, rrezikon ta humbë kujdestarinë primare.

Dakota dhe Chris në lidhje

Sipas disa raportimeve, Dakota Johnson dhe Chris Martin janë në lidhje romantike që nga vjeshta e vitit që shkoi. Edhe pse çifti janë munduar ta mbajnë lidhjen e tyre larg vëmendjes së medieve, ata janë parë së bashku ditën e martë. Dyshja ishin tejet të afërt në një dalje për drekë në Venice Beach, në Kalifornia. Aktorja 28-vjeçare dhe vokalisti i "Coldplay" u munduan të mos tërheqin vëmendje, por janë kapur nga aparati fotografik i paparacëve.



Paris Hilton së shpejti me 'reality shou' për jetën e vet



Paris Hilton mund të kthehet me 'reality shou' në televizion. Ky shou televiziv mund ta dokumentojë jetën e saj të re me të fejuarin Chris Zylka. "Ne kemi marrë shumë thirrje dhe shumë

oferta nga shumë televizione për një shou të tillë", ka thënë ajo për "E! News". Ajo ka thënë "po" kur është pyetur nëse do të ishte në gjendje të realizonte një reality shou për jetën e saj tani.

E rrallë

Kapet në Kinë peshku me "kokë zogu"

Një peshk i çuditshëm është bërë viral në internet për shkak të kokës së pazakontë që e ka si të "zogut". Disa thanë se koka e peshkut duket si një kokë e një pëllumbi ose një papagalli, ndërsa të tjerë argumentuan se ajo ngjan më shumë me atë të një delfini.




FOTO E DITES



Elefantët marrin pjesë në një lojë futbollit në qytetin e lashtë tajlandez të Ayutthayas. /AFP/

E jashtëzakonshme

Varros babanë brenda BMW-s 66 mijë dollarëshe

Një djalë nigerian e ka varrosur babanë e tij brenda një BMW-je, në vend të një arkivoli. Djali i pasur, i identifikuar vetëm si Azubuike, humbi babanë e tij por, sipas medieve lokale, gjithmonë i kishte premtuar atij një ditë se do të kishte një makinë luksoze. E teksa i ati vdiq



në fshatin e largët Ihiala, Azubuike bleu një BMW 66 mijë dollarë për ta varrosur të atin.

BARSOLETA E DITËS



Dentisti: Hej, këto pare që m'i dhe janë fals!

Pacienti: Edhe dhëmbët që m'i vuri s'ishin origjinalë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjatë vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Fillimi i kësaj dite i është dedikuar i gjithi punës. Jeni shumë të zënë me projekte që duhet t'i realizoni sa më shpejt.</p>	 <p>DEMI Kujdes me emocionet sot. Shumë herë shkoni në drejtim të gabuar vetëm sepse ndikoheni nga emocionet e momentit.</p>	 <p>BINJAKËT Familja juaj nuk është se e pranon shumë lidhjen e re sentimentale që sapo keni nisur. Një debat i papritur sot midis partnerit dhe njerëzve të afërt.</p>	 <p>GAFORRJA Për më të vegjlit e shenjës shkolla apo kopshti do të sjellë angazhime të reja. Të gjithë do të jenë të preokupuar me këtë ngjarje sot.</p>	 <p>LUANI Nëse keni planifikuar një udhëtim pune, mund të jeni të qetë. Gjithçka do të shkojë mjaft mirë dhe ju do të ktheheni me lajme pozitive.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Gjërat në përgjithësi janë në harmoni të plotë sot për ju. Përveç ndonjë problemi të vogël në çift, që do të zgjidhet shpejt.</p>
 <p>PESHORJA Edhe pse brenda mureve të shtëpisë do të ketë debat, do të jeni ju që do të shuani çdo mosmarrëveshje. Në fund të ditës do të jeni një familje e bashkuar.</p>	 <p>AKREPI Sot do të keni disa probleme sa iu përket financave. Do të dalin shpenzime të pallogaritura më parë, që do t'ju prishin disi rendin e ditës.</p>	 <p>SHIGJETARI Do t'ju përfshijnë në projekte që nuk janë ide e juaja në punë. Kjo gjë nuk është se ju pëlqen, megjithatë do të jepni me të mirë.</p>	 <p>BRICJAPI Këtë periudhë keni pasur probleme me gjumin. Bëni mirë të kujdeseni më shumë për veten dhe ta anashkaloni pjesën tjetër të ngarkesës.</p>	 <p>UJORI Sot ndiheni shumë nostalgjik, mbase nga koha, mbase sepse kujtimet nuk ju lenë të qetë. Ka gjëra që është mirë të mos i rikujtoni shpesh.</p>	 <p>PESHQIT Besimi i madh që keni tek miqtë tuaj vjen si pasojë e sigurisë që ju kanë dhënë në çaste të vështira. Pa ata ndiheni i humbur.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE HALMSTADS - HELSINGBORGS **GG3+** RUSSIA - SAUDI ARABIA **1** BOTAFOGO - PARANAENSE **1**

Vazhdojnë nderimet për Fadil Vokrrin

FIFA e ka nderuar legendën e futbollit të Kosovës, Fadil Vokrrin, me një minutë heshtje në Kongresin e 69. Nderim me një minutë heshtje i ka bërë edhe skuadra austriake SV Grodig Salzburg, ndërsa Partizani i Beogradit i ka kushtuar një dokumentar ish-yllit të saj



EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrrit, i është dhënë lamtumira e fundit të dielën, por ai vazhdon të kujtohet e të nderohet anekënd botës. Institucioni i lartë i futbollit, FIFA, në Kongresin e 69 në Moskë, ka nderuar kryetarin tashmë të ndjerë të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokri, me një minutë heshtje. Në këtë kongres ishte paraprë të merrte pjesë Vokri së bashku me nënkryetarin Agim Ademi dhe sekretarin e përgjithshëm, Eroll Salihu.

Megjithatë, në mëngjesin e së shtunës papritur ndërroi jetë legjenda, i cili ishte në hovin më të madh të zhvillimit të futbollit të Kosovës. Në Moskë nuk ishte fizikisht presidenti Vokri, por jeta dhe vepra e tij u nderua me një minutë heshtje në fillim të punimeve të Kongresit të FIFA-s, duke lënë gjurmë të pashlyshme edhe në historinë e shtëpisë së futbollit botëror. Në këtë kongres Kosova u përfaqësua nga nënkryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe menaxheri Bajram Shala.

Nderim kryetarit tashmë të ndjerë të FFK-së i ka bërë edhe skuadra austriake, SV Grodig Salzburg. Në këtë skuadër

aktivizohet futbollisti me prejardhje nga Kosova, Djellon Çunaku. Para ndeshjes të gjithë futbollistët mbajtën në duar fotografinë e Fadil Vokrrit, teksa kanë mbajtur edhe një minutë heshtje.

Legjenda e futbollit të Kosovës dhe kryetari i FFK-së, Fadil Vokri, pas vetes la një karrierë

të pasur prej futbollisti dhe kontributin e paçmueshëm si kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës, në anëtarësimin e Kosovës në UEFA dhe FIFA. Ai u cilësua si ikona e futbollit të Jugosllavisë, ku bëri karrierë të bujshme me Prishtinën dhe Partizanin e Beogradit. Pikërisht, kjo e fundit ka bërë

edhe një dokumentar të shkurtër që e ka shfaqur në televizionin e klubit. Disa prej momenteve më të rëndësishme, si dhe golat që nuk janë parë ndonjëherë, janë shfaqur në këtë film. 57-vjeçari ishte shpallur kampion me klubin serb, duke i sjellë titullin pas më shumë se tri dekada.

Bota prej sot kthen sytë kah Rusia, kah Botërori

Botërori "Rusi 2018" do ta ketë rëndësinë e vet edhe për shqiptarët, pasi në ceremoninë hapëse do të paraqitet këngëtarja Era Istrefi, kurse pjesëmarrës janë edhe futbollistët shqiptarë: Valon Behrami, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri, Blerim Xhemaili dhe Adnan Januzaj

MOSKË, 13 QERSHOR (ER) - Ngjarja më e madhe e futbollit në nivel nacional, Kupa e Botës "Rusi 2018", fillon sot (e hënë) në stadiumin "Luzhnik" të Moskës, ku edhe do të zhvillohet finalja e këtij eventi. E rëndësishme kjo Kupë është për shqiptarët, pasi në ceremoninë hapëse do të këndojë Era Istrefi së bashku me Will Smith dhe Nicky Jam. Kjo është një arritur e madhe për një këngëtare shqiptare, kurse Era nuk do të jetë përfaqësuesja e vetme në Botëror, të cilin fatkeqësisht nuk e ka siguruar Shqipëria e as Kosova, por shqiptarët i kanë pesë futbollistë që mbrojnë ngjyrat e Zvicrës, përkatësisht Belgjikës. Bëhet fjalë për katërshen që e bartë barrën krye-

sore në Kombëtaren e Zvicrës, Valon Behrami, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Blerim Xhemaili, derisa Adnan Januzaj do të luajë për Belgjikën.

Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka shprehur optimizëm se gjithçka do të shkojë në mënyrën më të mirë. "Mezi po e pres festën e madhe. Sigurisht se do të kemi sfida të caktuara, si lufta kundër racizmit apo VAR-i që do të përdoret për herë të parë në Kupën e Botës. Por, për eventin gjithçka është gati dhe mund të them se do të jetë një ngjarje fantastike, me tifozë që do të vijnë nga e gjithë bota. Duhet të dini se pas rusëve janë amerikanët që kanë blerë më shumë bileta, ndjekur nga brazil-

FIFA WORLD CUP RUSSIA 2018 FINAL DRAW DRAW RESULTS

GROUP A RUSSIA SAUDI ARABIA EGYPT URUGUAY	GROUP B PORTUGAL SPAIN MOROCCO IR IRAN	GROUP C FRANCE AUSTRALIA PERU DENMARK	GROUP D ARGENTINA ICELAND CROATIA NIGERIA
GROUP E BRAZIL SWITZERLAND COSTA RICA SERBIA	GROUP F GERMANY MEXICO SWEDEN KOREA REPUBLIC	GROUP G BELGIUM PANAMA TUNISIA ENGLAND	GROUP H POLAND SENEGAL COLOMBIA JAPAN

ianët dhe gjermanët. Është shumë interesante. Më shumë se gjysma e biletave janë shitur jashtë, ndërsa shumë mendonin se askush nuk do të udhëtonte drejt Rusisë", ka thënë ai. Ndeshja e parë hapëse do të jetë në mes të nikoqires, Rusisë

dhe Arabisë Saudite, në orën 17:00. Kjo është ndeshja e vetme për ditën e parë të Botërorit. Ndryshe nga herët e tjera ceremonia hapëse do të zhvillohet vetëm gjysmë ore para se të fillojë ndeshja e parë. Pjesëmarrëse janë 32 shtete, ku nga

shumica prej tyre do të tentojnë ta fitojnë trofeun e më të mirit. Triumfi në këtë Botëror është i përfshirë edhe në duel mes futbollistësh, ku spikat përballja historike Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo.

2.4 milionë bileta të shitura, amerikanët të parët

MOSKË, 13 QERSHOR - Tifozët amerikanë kanë blerë më shumë bileta të Kupës së Botës se çdo vend tjetër, edhe pse përfaqësuesja e ShBA-së nuk arriti të kualifikohet në turneun më të rëndësishëm futbollistik. Të

dhënat e publikuara nga vetë FIFA tregojnë se në total janë shitur 2.4 milionë bileta për këtë kompeticion, ku do të zhvillohen 64 ndeshje. Në fillim të kësaj jave ishin 871 797 bileta që iu shitën tifozëve, nga të cilat rreth 90 mijë

u blenë nga amerikanët që nga muaji shtator. Pas ShBA-së, numri më i lartë i biletave të shitura të Botërorit është shënuar në Brazil, vendi i skuadrës 5 herë kampione të botës, me 72 512 bileta, më pas vijnë Kolumbia,

Meksika, Argjentina dhe Peruja. Ndërsa në vendin e kampioneve të botës, Gjermani, numri i biletave të shitura arriti në 62 541. Në dhjetëshen e vendeve ku janë shitur më shumë bileta janë edhe Kina, Australia, Polonia, Suedia e

Danimarka. Ajo që të bën përshtypje është se në Angli, vendi që dallohet për tifozëri të zjarrtë, janë shitur vetëm 32 000 bileta për shkak të frikës që ekziston për shfaqjen e dhunës dhe abuzimeve raciste në Rusi.

Silva: E kemi harruar humbjen 7-1

MOSKË, 13 QERSHOR - Kapiteni i Kombëtares së Brazilit, Thiago Silva, e quan të kaluar dhe të harruar humbjen e turpshme 7-1 në gjysmëfinalen e Kupës së Botës katër vjet më parë ndaj Gjermanisë. "2014-a nuk luan asnjë rol në mendjen tonë", shprehet

mbrojtësi i PSG-së për "Sport Bild". "Skuadra aktuale nën urdhrat e trajnerit Tite është shumë e fortë mendërisht. Fitorja 1-0 ndaj Gjermanisë në mars ishte shumë e mirë për vetëbesimin tonë. Kemi kualitetet për t'u shpallur kampionë

dhe për ta shkruar historinë", ka shtuar ai. Megjithëse ka bërë një pauzë të gjatë, Silva mendon se Neymari do të jetë në formë të mirë: "Talentit i tij është një dhuratë nga Zoti dhe nuk mund të humbasë nga një dëmtim".



Komuna e Prishtinës nuk lejon transmetimin e Botërorit në shesh



PRISHTINË, 13 QERSHOR - Komuna e Prishtinës ka marrë vendim të mos lejojë transmetimin e Kampionatit Botëror "Rusia 2018" në shesh. Ky transmetim ishte planifikuar të bëhet nga kompania "KD Events", por asaj i është revokuar pëlqimi nga Komuna. Zyrtarë të Komunës së Prishtinës nuk kanë dashur të flasin për këtë çështje, duke mos dhënë asnjë sqarim. Drejtori Ekzekutiv i "KD Events", Kushtrim Demiri, në një konferencë për media ka thënë se një eveniment të ngjashëm kishin organizuar edhe para dy vjetësh,

por kësaj radhe nuk u lejua një gjë e tillë duke mos ditur arsyen e vërtetë të komunës dhe kryetarit të saj, Shpend Ahmeti. Demiri bëri me dije se kompania që ai drejton ka kryer të gjitha detyrimet dhe ka marrëveshje me transmetuesin publik për transmetimin në shesh të këtij event sportiv, ndërsa ka paralajmëruar se kjo çështje nuk do të përfundojë me kaq, pasi moslejimi i transmetimit në shesh bëhet për interese personale të Komunës së Prishtinës. "Ne do t'i marrim të gjitha hapat ligjorë, t'i shfrytëzo-

jmë thjesht për humbjen që na kanë kushtuar. Por, gjithsesi edhe padia penale, edhe padia civile ndaj të gjithë personave që i kanë shkelur këto, për arsye se qyteti është i Prishtinës, i qytetarëve të saj, jo i kryetarit", tha Demiri. "KosovaPress"-i ka kontaktuar edhe me Komunën e Prishtinës, por Zyra për Media nuk ka qenë e gatshme të japë përgjigje. Ndërsa Habib Qorri nga Komuna e Prishtinës, duke mos dashur të flasë para kamerave, deklaroi "se nuk është çështje për të cilën duhet të flasë".

Spanja shkarkon Lopeteguin, Hierro emërohet trajner

MADRID, 13 QERSHOR - Spanja e ka shkarkuar trajnerin një ditë para fillimit të Botërorit të Rusisë. Presidenti i Federatës Spanjolle të Futbollit ka njoftuar për këtë vendim. "Ne e falënderojmë Julen për gjithçka që ka bërë. Falë tij ne jemi në Rusi, por jemi të detyruar ta shkarkojmë. Ky duhet të jetë një mesazh i qartë për të gjithë punonjësit e Federatës Spanjolle. Unë kam folur me të. Nuk do të ndihem i tradhtuar, por problemi është se si ai ka bërë gjëra me mendjen e tij si trajner i Spanjës. I ka bërë këto veprime në mungesë totale të pjesëmarrjes së Federatës së Futbollit të Spanjës, duke negociuar dhe pranuar stolin e Real Madridit. Kjo është diçka që ne nuk mund ta injorojmë", ka thënë Luis Rubiales. "Lojtarëve ua kam dhënë shpjegimet e mia dhe më kanë mirëkuptuar. Angazhimi i tyre është i plotë dhe nuk kam asnjë dyshim se do të japin gjithçka, pavarësisht kësaj që ndodhi. Federata nuk ka qenë në gjendje të bëjë asgjë tjetër, gjithçka që ka ndodhur, nuk është zgjedhur prej nesh. Real Madridi po kërkon një trajner dhe po kërkon më të mirin,



është e ligjshme, nuk do të them asgjë për këtë. Por trajneri, ndërsa është punonjës i Federatës Spanjolle, nuk mund të bëjë gjëra në këtë mënyrë", ka deklaruar ai.

Federata Spanjolle menjëherë të mërkurën e ka emëruar trajner të ri Fernando Hierro, i cili do ta drejtojë Spanjën në Kupën e Botës 2018.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Maliq Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHF "Nazim Buduri" Hoqe e Qytetit.

► Rizan Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

SHKURT

Shigjetarët përgatiten për Lojërat Mesdhetare

Kombëtarja e Kosovës në shigjetari është duke vazhduar përgatitjet për Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Ekipi i përbërë nga Ardita Zejnullahu, Atdhe Luzhnica dhe Hazir Asllani janë duke u përgatitur me trajnerin e tyre, Fehmi Bylykbashi. Të gjithë këta do të përfaqësojnë Kosovën në sportin e shigjetarisë në "Tarragona 2018". Shigjetarët po përgatiten në "Hotel Solid" të Suharekës. "Ekipi ka filluar kampin stërvitor prej 6 qershorit në 'Hotel Solid' ku, përveç infrastrukturës së nevojshme për sportin e shigjetarisë, ky resort ka edhe pishinat për notë, që është një prej elementeve kyçe të programit stërvitor", thuhet në njoftimin e Federatës Shigjetare të Kosovës (FShK). Shigjetarët do të stërviten në Solid deri më 14 qershor, kurse gjashtë ditë më vonë (20 qershor), për shkak të orarit të garave, do të nisen të parët drejt Tarragonës së Spanjës, ku prej 22 qershorit deri më 1 korrik mbahen Lojërat Mesdhetare.

Scolari: Neymari nuk është lojtari kryesor në Brazil

Ish-trajneri i Kombëtarës së Brazilit, Luiz Felipe Scolari, ka thënë se ylli Neymar nuk është lojtari kryesor në skuadrën e Brazilit për Kupën e Botës "Rusi 2018". "Casemiro është lojtari që bën diferencën te kombëtarja e Brazilit. Ai i jep ekuilibër skuadrës dhe është lojtari që lejon si Marcelon, ashtu edhe Neymarin që të bashkëpunojnë më shumë në sulm dhe të mos mendojnë për mbrojtjen. Duke qenë ai në fushën e lojës, të tjerët kanë më shumë lirshmëri", ka thënë Scolari.

Botërori i 2026-s zhvillohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada

FIFA ka përcaktuar edhe organizatorët e Botërorit të vitit 2026. Si kurrë më parë, eventit më të rëndësishëm i globit do të zhvillohet në tri shtete, ShBA, Meksikë dhe Kanada. Kongresi vjetori i FIFA-s u mbajt të mërkurën, një ditë para fillimit të Kupës së Botës në Rusi, ku mbi 200 federata kombëtare votuan në Moskë dhe zgjodhën që Botërori i vitit 2026 të zhvillohej në ShBA, Meksikë dhe Kanada. Ky do të jetë Botërori i parë që do të zhvillohet me formulë të re, pra me 48 skuadra pjesëmarrëse. Tri shtetet, ShBA, Meksika dhe Kanadaja, mposhtën kandidaturën e Marokut. 134 me 64 ishte rezultati i votimit.

Chelsea, 50 milionë euro për Donnaruman

Skuadra e Chelseat ka ofruar 50 milionë euro për blerjen e Gianluigi Donnarumas nga AC Milan, raporton "The Sun". Madje drejtuesit e skuadrës angleze janë gati ta përfshijnë në marrëveshje edhe sulmuesin Alvaro Morata, i cili nuk ka treguar gjithë potencialin në Londër, derisa në anën tjetër mund të jetë shumë i vlefshëm për skuadrën kuqezi.

Bayerni, gati ta shesë Boatengun

Karl-Heinz Rummenigge ka bërë me dije se Jerome Boateng mund të largohet nga Bayern Muncheni. Ai ka konfirmuar se klubi do t'i shqyrtojë ofertat që vijnë në drejtim të mbrojtësit. "E dimë se mund të na vijë një ofertë për të. Nëse një klub vjen dhe kërkon të dijë për çmimin e tij, atëherë do të merremi me atë çështje. Po ju them se vlera e tij nuk është e ulët, por gjithçka për momentin është vetëm spekulim. Jam në dijeni se Jerome po merret me këtë temë", ka thënë Rummenigge.



URIMI I MINISTRIT YAGCILAR DREJTUAR BESIMTARËVE ISLAM

Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Yagcilar, të gjithë besimtareve islam ua uron festën e Fiter Bajramit.

Ministar Ministarstva Javne Uprave, Mahir Yagcilar, svim islamskim vernicima čestita verski praznik Fitr Bajram.

Kamu Yönetimi Bakanı, Mahir Yağcilar bütün İslam alemi'nin Ramazan Bayramını kutlar.

Mahir Yagcilar, ministër MAP-it



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

Ministria e Zhvillimit Ekonomik të gjithë qytetarëve të besimit islam ju uron festën e Fiter Bajramit!



Me fat
Fitër Bajrami

KEDS **KES|CO**





Qendra për Mjekësi Fizikale
dhe Rehabilitim

Nëna Naile

Banja në Kllokot - Kosovë

**Me fat
Fitër
Bajrami!**



Tel&Fax: 0280 385 101, 0280 385 555 • Mob: 044 666 006, 045 385 555 • info@nenanaile.com • www.nenanaile.com

Sot bëhen 10 vjet pa më të dashurin tonë

HYSEN IBRA

(09.02.1948-14.06.2008)


10 vite kaluan
Me dhimbje e dëshpërim,
sa shumë që na mungon
u preftsh në amshim.

Të qartë e kemi përfytyrimin
ulur pranë tavolinës se si punoje,
në kokë na kumbojnë fjalët
kur për atdheun diskutoje.

Nuk kurseve as mendjen
e as shëndetin,
që shqiptarët
ta udhëheqin shtetin.

Shtetin për të cilin punove
me laps e me fuqi,
që pasardhësit tanë
ta gëzojnë të shtrenjtën liri,

**Të përkujtojnë me mall: bashkëshortja Gjyla, vajzat
Shqiponja, Yllka, Liridona, Qëndresa, Kushtrimja dhe
djali Shqiptari.**



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 1162/18, datë 12.06.2018.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit të datës 12.06.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për përsëritje pjesërisht të Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr. 815, datë 22.05.2018, vetëm për tri (3) pozitat:
 1. Drejtor i Qendrës Kombëtare të Telemjekësisë në Prishtinë;
 2. Drejtor i Q. Shëndetit Mendor në Shtëpitë Integruare në Bashkësi Prizren;
 3. Drejtor i Q. Shëndetit Mendor në shtëpi Integruare në Bashkësi Gjilan.

Vazhdohen edhe për dy javë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit. Ndërsa pikat 1, 2, 3 dhe 5 të konkursit vazhdojnë më përzgjedhje.
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni përzgjedhës sipas Vendimit nr. 815/3 datë 24.05.2018, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit gjeti se për pozitat 1, 2, 3 dhe 5 (Drejtorë të nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në SHSKUK, i plotësojnë kushtet për përzgjedhje, ndërsa pozitat 4, 6 dhe 7 sipas këtij konkursi nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkohet që tri pozitat në fjalë të vazhdohen sipas nenit 6, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, edhe 15 ditë, ku kërkohet që konkurrenca të jetë me e madhe për këto tri pozita.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe rekomandimit në fjalë, lejon përsëritjen e pjesërisht të Konkursit publik për tri pozita Drejtorë të nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në SHSKUK edhe për dy javë, ndërsa katër pozitat tjera mbesin të njëjta.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
✓ Zyrës së personelit,
✓ Një mediumit informativ.
✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Kadrovska Sluzba

Nr.Ref. 1162/18, data 12.06.2018.

U shtet sa članom 13 stav 3 Statuta Kosovske bolnice i službe za kliničku bolnicu, članom 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkursa u javnom sektoru, i Preporuka Komisije za izbor dana 12.06.2018, Generalni Direktor SHSKUK-a izdao je sledeće:

O D L U K A

Za ponavljanje djelimično javnog konkursa

- I. Javni Konkurs br. 815, od 22.05.2018. Godine, samo za tri (3) pozicije:
 1. Direktor Nacionalnog Centra za Telemedicinu u Prištini;
 2. Direktor Centra za Mentalno Zdravlje u Integriranim Zajednicama u Opštini Prizren;
 3. Direktor Centra za Mentalno Zdravlje u Zajednici Integrativne Zajednice u Gnjilanu.

Oni traju dve nedelje od dana objavljivanja u jednom od medija.
Dok tačke 1, 2, 3 i 5 Konkursa i dalje budu izabrane.
- II. Sektor kadrova je obavezan da izvrši ovu Odluku;
- III. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o Ź e n j e


Komisija za izbor prema Odluci br. 815/3 od 24.05.2018. Godine, tokom pregleda dokumentacije, utvrdio je da za pozicije 1, 2, 3 i 5 (direktori sekundarnih zdravstvenih službi u UBKSK ispunjavaju kriterijume za izbor, dok su pozicije 4, 6 i 7 prema ovom konkursu ne ispunjavaju uslove i zahteva se da se tri pozicije budu produžene u skladu sa članom 6, tačka 5.1 Administrativnog Uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka Konkursa u javnom sektoru, za još 15 dana u kojima je potrebna konkurencija veći za ove tri pozicije.

Stoga, prema nadležnostima, prema važećem zakonu i preporuci, Generalni Direktor UBKSK dozvoljava djelimično ponavljanje javnog Konkursa za tri Direktora Sekundarnih Zdravstvenih službi u nivou UBKSK I dvije nedelje, dok četiri ostale pozicije ostaju iste. Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



*Urime festa e
Fiter Bajramit*

